



Drejtoria për Arsim

04 Nr. 111-27220 /2026

Datë 21.08 /2026

Në bazë të nenit 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës si dhe në kërkesën e IAAP "Fehmi Agani" në Klinë nr.04-111-27193/26 e datës 21.08.2026, Drejtoria e Arsimit më datën 21.08.2026, shpall këtë:

K O N K U R S

Për regjistrimin e vijuesve të rritur në arsimin e mesëm të lartë të arsimit profesional-klasa X

Nr.	Shkolla	Nr.i paraleleve	Nr.i nxënësve	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	IAAP "Fehmi Agani"	1	11	Informatikë	11
		1	11	Instalues Elektrik	11
		1	11	Automekanik	11
		1	11	Instalues Ujësjiellësit dhe Kanalizimit	11
		1	11	Instalues i Ngrohjes e Kanalizimit dhe Ujësjiellësit e Kanalizimit	11
		1	11	Trafik Rrugor	11
		1	11	Operator Prodhimi	11
		1	11	Gjeologji	11
		1	11	Xehetari	11
		1	11	Laborant i Biologjisë	11
		1	11	Kontabilitet dhe Tatime	11
		1	11	Agrobiznes	11
		1	11	Ndërtimtari	11
		1	11	Konfeksion	11
		1	11	Teknologji ushqimore	11
		1	11	Përpunues i prodhimeve ushqimore	11
Gjithsej		16	176		176

-REGJISTRIMI I VIJUESVE NË PROGRAMIN "Arsimi për të rritur", bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënës të rregullt, siç është paraparë në Ligjin nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve Administrative të MASHT-it .

Në programin “Arsimi për të rritur” në shkollat e mesme të larta, vijuesve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi (UA nr. 40/2006 MASHT).

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Deftesat e klasave të kryera paraprake.
2. Ekstrakti i lindjes.
3. Pagesa.

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të Rregullores nr. 01/2017, dt. 02.02.20217 për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional dhe arsimit për të rritur, rregullore për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale nr. 0-434-1677/2019 e datës 25.04.20219.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- Për regjistrim të vitit (për një klasë).....100 €;
- Për praktikë profesionale.....50 €;
- Provim diferencial.....10 €;
- Provimi përfundim, certifikatën-diplomën.....50 €;

Pagesat bëhen në institucionet përkatëse edukativo-arsimore sipas kodeve të shkollave:

Vijuesit, të cilët ndërrojnë profilin, do t’u nënshtrohen provimeve diferenciale, bazuar në UA 16/20211, dt. 30.12.2011 të MASHT-it.

Kandidatët, të cilët ndërrojnë drejtimin, janë të obliguar që paraprakisht t’u nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës, për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin “Arsimi dhe aftësimi për të rritur” janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në webfaqe te komunës dhe në tabelën e shpalljeve në IAAP “Fehmi Agani” në Klinë.

Drejtori i DKA-së
Dr.sc. Qemajl Sejdijs

